



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 24.2.2025

Nr: 150

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA BALLI KOMBËTAR”, ME KRYETAR Z. ADRIATIK ALIMADHI, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025

Sot më datë 24.2.2025, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën nr. 1163 Prot., datë 20.02.2025, me:

- Kërkues:** Partia politike “Partia Balli Kombëtar”, me kryetar z. Adriatik Alimadhi.
- Objekti:** Regjistrimi i partisë politike “Partia Balli Kombëtar” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.
- Baza ligjore:** Neni 64 i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 399, datë 05.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvend.

“Partia Balli Kombëtar”, nëpërmjet Kryetarit, Z. Adriatik Alimadhi, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 18.02.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia Balli Kombëtar”, me initiale “P.B.K”, me Kryetar Z. Adriatik Alimadhi, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Data: 24.2.2025 Nr: 150
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Balli Kombëtar”, me kryetar Z. Adriatik Alimadhi, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025”

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë “Partia Balli Kombëtar” me shkronja nistore “P.B.K”, me adresë: Rruga e Kavajës, Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është Z. Adriatik Alimadhi, me adresë: Rruga "Myslym Keta", Tiranë;
- c) Financieri i partisë është Z. Kujtim Lamaj, me adresë: Rruga e Kavajës, Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është Z. Adriatik Alimadhi, me adresë: Rruga "Myslym Keta", Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia Balli Kombëtar”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga “Partia Balli Kombëtar”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.1.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025”.

V E N D O S :

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia Balli Kombëtar”, me kryetar Z. Adriatik Alimadhi, me shkronjat nistore “P.B.K”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI